

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Pasqyrat Financiare

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(me raportin e audituesve të pavarur)

Përmbajtja

	<u>Page</u>
Raporti i audituesve të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	5 – 22



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-officio@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarit të:
Albania Marketing Service Sh.p.k.

Tiranë, 8 maj 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Albania Marketing Service Sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2013, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013, rezultatit e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Steven Nutley
Partner

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Building
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Pasqyra e pozicionit financiar

(Vlerat në Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Aktive			
Aktive afatgjata materiale	5	122,370,429	137,520,232
Aktive afatgjata jomateriale	6	5,973,543	507,622
Totali i aktiveve afatgjata		128,343,972	138,027,854
Kërkesa për arkëtim ndaj palëve të lidhura dhe të tjera	7	305,906,077	252,498,097
Tatimi fitimi i parapaguar		2,283,472	-
Aktive të tjera	8	8,815,217	13,945,813
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	52,852,355	43,918,695
Totali i aktiveve afatshkurtra		369,857,121	310,362,605
Totali i aktiveve		498,201,093	448,390,459
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali themeltar	10	12,300,000	12,300,000
Rezerva të tjera		55,192,556	55,192,556
Fitime të mbartura		220,288,084	237,085,222
Totali i kapitalit aksioner		287,780,640	304,577,778
Huatë	11	-	666,922
Detyrime ndaj palëve të lidhura	14	46,459,956	19,483,353
Llogari të pagueshme	12	30,216,563	26,747,701
Tatim fitimi pagueshëm		-	920,006
Detyrime të tjera	13	133,743,934	95,994,699
Totali i detyrimeve afatshkurtra		210,420,453	143,812,681
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		498,201,093	542,101,613

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse

(Vlerat në Lek)

	Shënimi	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Të ardhura nga shërbimet	15	1,579,810,864	1,241,681,518
Kostoja e shërbimeve	16	<u>(801,361,880)</u>	<u>(551,799,154)</u>
Fitimi bruto		<u>778,448,984</u>	<u>689,882,364</u>
Të ardhura të tjera		13,055,845	9,613,000
Totali i të ardhurave të tjera		<u>13,055,845</u>	<u>9,613,000</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	5,6	(43,136,713)	(36,320,443)
Shpenzime personeli	17	(210,952,590)	(160,693,005)
Shpenzime të tjera operative	18	<u>(285,068,900)</u>	<u>(228,123,025)</u>
Shpenzime operative		<u>(539,158,203)</u>	<u>(425,136,473)</u>
Fitimi nga aktivitetet operative		<u>252,346,626</u>	<u>274,358,891</u>
Të ardhura financiare	19	4,872,227	14,920,841
Shpenzime financiare	19	<u>(9,763,486)</u>	<u>(24,694,799)</u>
Shpenzime financiare, neto		<u>(4,891,259)</u>	<u>(9,773,958)</u>
Fitimi para tatimit		<u>247,455,367</u>	<u>264,584,933</u>
Tatimi mbi fitimin	20	(27,167,283)	(28,734,108)
Fitimi neto i periudhës		<u>220,288,084</u>	<u>235,850,825</u>
Të ardhura përmbledhëse të tjera, neto		-	-
Fitimi përmbledhës neto për periudhën		<u>220,288,084</u>	<u>235,850,825</u>

Pasqyra e të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Vlerat në Lek)

	Kapitali themeltar	Fitime të mbartura	Rezerva	Totali
Gjendja më 1 Janar 2012	12,300,000	235,850,825	31,607,474	279,758,299
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi i vitit, neto	-	237,085,222	-	237,085,222
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	237,085,222	-	237,085,222
Veprime me aksionerët, regjistruar direkt në kapital				
Kontribute nga aksionerët				
Pagesa dividendi	-	(212,265,743)	-	(212,265,743)
Shpërndarja e fitimeve të mbartura	-	(23,585,082)	23,585,082	-
Totali i veprimeve me aksionerët	-	(235,850,825)	23,585,082	(212,265,743)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	12,300,000	237,085,222	55,192,556	304,577,778
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi i vitit, neto	-	220,288,084	-	220,288,084
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	220,288,084	-	220,288,084
Veprime me aksionerët, regjistruar direkt në kapital				
Kontribute nga aksionerët				
Pagesa dividendi	-	(237,085,222)	-	(237,085,222)
Shpërndarja e fitimeve të mbartura	-	-	-	-
Totali i veprimeve me aksionerët	-	(237,085,222)	-	(237,085,222)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	12,300,000	220,288,084	55,192,556	287,780,640

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Pasqyra e flukseve monetare

(Vlerat në Lek)


	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Flukse monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi neto i periudhës	220,288,084	237,085,222
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	38,292,227	33,939,573
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	4,844,486	160,413
Tatimi mbi fitimin	27,167,283	29,097,574
Shpenzime interesi dhe tarifa bankare	54,052	310,766
Fitimi operativ para ndryshimit të kapitalit punues	<u>290,646,132</u>	<u>300,593,548</u>
Ndryshimi në kërkesa për arkëtim prej palëve të lidhura	(53,407,980)	94,992,285
Ndryshimi në kërkesa të tjera për arkëtim	5,130,596	12,046,575
Ndryshimi në detyrime ndaj palëve të lidhura	26,976,603	(115,315,811)
Ndryshimi në të pagueshmet ndaj furnitorëve	3,468,862	(794,866)
Ndryshimi në detyrimet e tjera	<u>37,749,235</u>	<u>4,462,178</u>
Mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	<u>310,563,448</u>	<u>295,983,909</u>
Tatim fitimi i paguar	(30,370,761)	(35,249,114)
Interesi i paguar	(54,052)	(310,766)
Mjete monetare neto nga aktivitetet operative	<u>280,138,635</u>	<u>260,424,029</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(23,142,424)	(29,394,959)
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	(10,310,407)	
Mjete monetare të përdorura në aktivitetet investuese	<u>(33,452,831)</u>	<u>(29,394,959)</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financuese		
Dividendi i paguar	(237,085,222)	(212,265,743)
Ripagim i huave	(666,922)	(730,594)
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese	<u>(237,752,144)</u>	<u>(212,996,337)</u>
Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	8,933,660	18,032,733
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 Janar	<u>43,918,695</u>	<u>25,885,962</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor (Shënimi 9)	<u>52,852,355</u>	<u>43,918,695</u>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë Albania Marketing Service Sh.p.k. më datë 8 maj 2014 dhe u firmosen në emër të saj nga:


Diego Pisa
Drejtor i Përgjithshëm




Studio Pustina
Drejtues Finance

STUDIO "PUSTINA" Sh.p.k
NIP/ID: 11326002B
Rr. «Abdyli Frashëri» 31, Pallati
«Hekla» Tiranë

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Albania Marketing Service Sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 20 Shkurt 2009, dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 25 Shkurt 2009. Shoqëria ka kapital themeltar prej 12,300 mijë Lek të ndarë në 12,300 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lek secili. Aksionet janë 100% në pronësi të Albania Investment Holdings Mauritius. Kompania mëmë është Teleperformance France SA.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është sigurimi i shërbimeve të telemarketingut klientëve të filialeve Italiane të Grupit Teleperformance.

Shoqëria vepron nëpërmjet dy qendrave të telefonisë, një në Tiranë dhe tjetra në Durrës. Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria kishte 1,512 punonjës (2012: 1,390 punonjës).

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhëshme që ndikohen.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë periudhën e paraqitur në këto pasqyra financiare

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitime ose humbje.

(b) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë, përfshijnë shumat e kërkesave nga palët e lidhura, aktive të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalente me to, huatë, llogari të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme. Gjatë periudhës së raportimit nuk ka investime në instrumenta kapitali apo instrumente borxhi.

Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre, përveç rasteve të përshkruara më poshtë. Në vijim, njohja e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3(k).

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka.

Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura

Kërkesat për arkëtim nga palët e lidhura njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimet.

Detyrimet ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të pagueshme

Detyrimet ndaj palëve të lidhura dhe llogaritë e tjera të pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Huatë dhe kreditë

Pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë minus kostot e transaksionit të lidhura direkt me këtë të fundit, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes, mbi bazën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale

(c) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme në blerjen e aktivit. Kostot e huamarrjes të lidhura me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e aktiveve të kualifikueshme njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ndodhin. Programet kompjuterike të blera që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve të lidhura me to kapitalizohen si pjesë e këtyre pajisjeve.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(i) Njohja dhe matja (vazhdim)

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimi me vlerën e mbartur të aktivitetit dhe njihet neto tek të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitime ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat përfaqësojnë me jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktiveve. Normat respektive të amortizimit për periudhën korrente janë si vijon:

	Në %
Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	20%
Automjete me qera financiare	20%
Mobilje dhe orendi	20-25%
Pajisje telefonike	20%
Pajisje kompjuterike	20-25%

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur, nëse nuk është e pakonsiderueshme, të aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(d) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet e afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga renia në vlerë.

Shpenzimet vijuese për aktivet e patrupezuara, kapitalizohen vetëm kur ato rritin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruar në aktivin perkates, me të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në momentin që ndodhin.

Amortizim njihet në pasqyrën e të ardhurave duke u bazuar në metodën e amortizimit zbritës. Norma vjetore e amortizimit është 25%-50%.

(e) Aktivet e marra me qera

Aktivitet e marra me qera në rastet kur Shoqëria merr përsipër pothuajse të gjithë rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë klasifikohen si qera financiare. Në momentin e njohjes fillestare, aktivi i marrë me qera matet me një shumë të barabartë me më të ultën midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qerasë. Pas njohjes fillestare, aktivi paraqitet sipas politikave kontabël të aplikueshme për atë aktiv.

Qera të tjera janë qerata operacionale, për të cilat aktivitet e marra me qera nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar. Humbja nga zhvlerësimi e një aktivit financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Aktivët financiarë të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare, vlerësohet bashkarisht në grupe që mbart karakteristika të ngjashme risku.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse anulimi mund të lidhet me objektivitet me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Për aktivët financiarë që maten me kosto të amortizuar, anulimi njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktivët jo-financiarë

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiarë të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivit tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

(g) Përfitimet e punonjësve

(i) Pensionet e detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(ii) Lejet vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

(h) Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të shkuar, dhe është e mundshme që të kërkohej një dalje burimesh që përmbajnë përfitimë ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe që detyrimin të mund ti bëhet një vlerësim i besueshëm. Nëse efekti është material, provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parasë me një normë-paratksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut, të vlerës në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme edhe riskun specifik të detyrimit. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më i mundshëm kushti për të cilin do të kërkohej materializimi i burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin, atëherë provigjionet kthen pas. Provigjionet përdoren vetëm për arsyen për të cilën janë njohur fillimisht. Provigjionet nuk njihen për humbje operative të ardhshme. Aktivët apo detyrimet e mundshme nuk njihen.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të pagesës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shuma të arkëtueshme për shërbimet e kryera gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto nga zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Të ardhurat nga shërbime të kryera njihen në fitim ose humbje në përpjesëtim me fazën e përmbushjes së transaksionit në datën e raportimit. Faza e përmbushjes vlerësohet duke iu referuar vrojtimit të punës së kryer.

(j) Pagesat e qerasë

Pagesat e bëra për qeranë operative njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë. Stimujt e marrë për qeranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qerasë përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepriçën e mbetur të detyrimit.

(k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e përllogaritjes në humbje ose fitim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, tarifa bankare dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Kostot e huave që nuk i ngarkohen direkt blerjes, ndërtimit apo prodhimit të një aktivi të kualifikuar, njihen në humbje ose fitim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe për qëllime tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur këto të rikthehen, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivët tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(l) Tatim fitimi (vazhdim)

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe atij të shtyrë, shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe gjithashtu faktin nëse taksa shtesë ose detyrime të tjera do lindin. Shoqëria beson se detyrimet e llogaritura për tatimin janë të përshtatshme për vitet në vazhdim pasi ka marrë në konsideratë një sërë faktorësh, përfshirë interpretimin e ligjit tatimor dhe eksperiencat e viteve të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlersëime dhe supozime që mund të përfshijnë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të shkaktojë ndryshime në gjykimet e Shoqërisë lidhur me detyrimet aktuale tatimore. Ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën që ky vendim do të merret.

(m) Standarde dhe politika të reja ende të pa-adoptuara

Për periudhat që fillojnë pas datës 1 Janar 2013 janë bërë efektive një seri standardesh të reja, rishikime dhe interpretime të atyre ekzistuese të cilat nuk janë aplikuar hershëm në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë efekt relevant në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtëm nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare

Drejtimi i Shoqërisë mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar risket që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Drejtuesit e grupit në zyrat qendrore vërtetojnë sesi menaxhimi monitoron përputhjen me politikat dhe procedurat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë dhe të vetë grupit dhe rishikon përshtatshmërinë e strukturës së menaxhimit të riskut në lidhje me rreziqet që përball Shoqëria.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, kërkesat për arkëtim dhe llogaritë e pagueshme, dhe huatë.

(a) Risku i kredisë

Në saj të volumit të kufizuar dhe të llojshmërisë së klientëve bazë të Shoqërisë, të cilët janë më së shumti ekskluzivisht palët e lidhura, përqendrimi i riskut për sa i përket kërkesave për arkëtim është i limituar. Provigjioni për kërkesat për arkëtim të dyshimta është caktuar në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e balancave të kërkesave për arkëtim.

4. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria do ndeshet në vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të lidhura me detyrimet financiare që shlyhen duke dhënë para të gatshme ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Drejtimi është në gjendje të përfitojë me shpejtësi pagesa nga palët e lidhura për kërkesat e arkëtueshme në rast të rënies së likuiditetit.

(c) Risku i tregut

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballlet me riskun e normës së interesit të rrjedhës së parave në lidhje me qeranë financiare e cila është me një norme të ndryshueshme. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky risk.

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballlet me risqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka balanca të konsiderueshme në Euro nga klientët e saj, të cilat janë të faturuara dhe arkëtuara nga palët e lidhura dhe kundrejt furnitorëve të saj, që ekspozojnë Shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për tu mbrojtur nga ky risk.

Analiza e ndjeshmërisë

Duke menaxhuar riskun e normave të interesit dhe të këmbimit valutor, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Një analizë e llogaritjes së impaktit në ndryshimin e përqindjes së normave të interesit dhe ndryshimeve të Lek-ut kundrejt monedhave të tjerave është paraqitur në Shënimin 21

Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Grupi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit pjestuar për totalin e kapitalit. Menaxhimi dhe Grupi gjithashtu monitorojnë nivelin e dividendëve.

Shoqëria kërkon që të mbajë një balancë midis kthimeve më të larta të cilat bëhen të mundura nga nivele më të larta borxhi dhe avantazheve dhe sigurisë që të jep një kapitalizim i fuqishëm.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatorë.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 përbehen si me poshtë:

Kosto	Kompjuter dhe pajisje	Mobilje dhe orendi	Pajisje telefonike	Përmirësime të ambjentëve me qera	Automjete	Totali
Më 1 Janar 2012	136,602,515	44,749,671	15,141,146	14,797,687	3,758,160	215,049,179
Shtesa	3,367,816	16,262,307	4,938,999	498,548	4,327,290	29,394,960
Më 31 Dhjetor 2012	139,970,331	61,011,978	20,080,145	15,296,235	8,085,450	244,444,139
Shtesa	5,242,208	9,343,774	4,455,002	1,161,440	2,940,000	23,142,424
Më 31 Dhjetor 2013	145,212,539	70,355,752	24,535,147	16,457,675	11,025,450	267,586,563
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 Janar 2012	(50,255,521)	(12,861,829)	(4,056,700)	(4,337,086)	(1,473,198)	(72,984,334)
Amortizimi për vitin	(22,320,895)	(7,811,833)	(2,667,406)	(538,204)	(601,235)	(33,939,573)
Më 31 Dhjetor 2012	(72,576,416)	(20,673,662)	(6,724,106)	(4,875,290)	(2,074,433)	(106,923,907)
Amortizimi për vitin	(20,744,298)	(10,450,626)	(3,337,590)	(2,165,510)	(1,594,203)	(38,292,227)
Më 31 Dhjetor 2013	(93,320,714)	(31,124,288)	(10,061,696)	(7,040,800)	(3,668,636)	(145,216,134)
Vlera kontabël						
Më 1 Janar 2012	86,346,994	31,887,842	11,084,446	10,460,601	2,284,962	142,064,845
Më 31 Dhjetor 2012	67,393,915	40,338,316	13,356,039	10,420,945	6,011,017	137,520,232
Më 31 Dhjetor 2013	51,891,825	39,231,464	14,473,451	9,416,875	7,356,814	122,370,429

Çështje të qera

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria nuk ka automjete me qira financiare (31 dhjetor 2012: një vlerë neto prej 1,827,969 Lek).

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

6. Aktivet afatgjata jomateriale

	Licensa
Kosto	
Më 1 Janar 2012	955,015
Shtesa	-
Më 31 Dhjetor 2012	955,015
Shtesa	10,310,407
Më 31 Dhjetor 2013	11,265,422
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 Janar 2012	(286,980)
Amortizimi për vitin	(160,413)
Më 31 Dhjetor 2012	(447,393)
Amortizimi për vitin	(4,844,486)
Më 31 Dhjetor 2013	(5,291,879)
Vlera kontabël	
Më 1 Janar 2012	668,035
Më 31 Dhjetor 2012	507,622
Më 31 Dhjetor 2013	5,973,543

7. Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura dhe te tjera

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Në EUR	Në LEK	Në EUR	Në LEK
IN & OUT S.p.a.	2,035,908	285,434,328	1,746,733	243,826,436
Gn Research S.p.A	84,218	11,807,389	43,222	6,033,410
Service 800 Albania Sh.p.k	37,800	5,299,560	18,900	2,638,251
Kërkesa nga palët e lidhura	2,157,926	302,541,277	1,808,855	252,498,097
Coca - Cola Albania	24,000	3,364,800	-	-
Totali	2,181,926	305,906,077	1,808,855	252,498,097

8. Aktive të tjera

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Tatim në burim i arkëtueshëm	1,353,444	2,288,193
Garanci për qera	4,500,420	4,355,208
Parapagime ndaj punonjësve	754,290	581,310
Shpenzime të shtyra	-	1,501,228
Të arkëtueshme të tjera	2,207,063	5,219,874
	8,815,217	13,945,813

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si me poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vlera në arkë	1,060,585	235,397
Vlera në llogari rrjedhëse	51,791,770	43,683,298
	52,852,355	43,918,695

10. Kapitali themeltar

Më 31 dhjetor 2013 kapitali i autorizuar, emtuar dhe i paguar i Shoqërisë është 12,300 aksione me një vlerë nominale prej 1,000 Lek për aksion.

Një përmbledhje e kapitalit më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 jepete si më poshtë:

	Numri i aksioneve	Lek
Albania Investment Holdings Mauritius	12,300	12,300,000

Shoqëria nuk ka të drejta, preferenca apo kufizime të lidhura me kapitalin më 31 dhjetor 2013.

11. Huatë

Huatë më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Monedha origjinale (EUR)	LEK	Monedha origjinale (EUR)	LEK
Banka Credins	-	-	4,778	666,922
	-	-	4,778	666,922

Detyrimet e qirasë financiare me 31 dhjetor 2012 në shumën 666,922 Lek lidhej me qerata financiare të automjeteve me terma fillestare 4 vjeçare. Shoqëria e shleu qirane financiare gjate vitit 2013 sipas termave kontraktuale te qirase financiare. Detyrimet e Shoqërisë nga qeraja financiare janë të siguruara nga titulli që qeradhënësi ka mbi aktivet e dhëna me qera.

Më poshtë paraqitet një rakordim i totalit të minimumit të pagesave të qirasë më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 me vlerën e tyre aktuale.

	Pagesa minimale e qirasë	Vlera aktuale e minimumit të pagesës së qirasë	Pagesa minimale e qirasë	Vlera aktuale e minimumit të pagesës së qirasë
	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2012
Jo më shumë se një vit	-	-	694,741	666,922
Më shumë se një vit dhe më pak se 5 vite	-	-	-	-
	-	-	694,741	666,922
Minus shpenzimet financiare të ardhshme	-	-	(27,819)	-
Vlera aktuale e pagesës së qirasë minimale	-	-	666,922	666,922

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

12. Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
CC Albania sh.p.k	12,752,690	12,752,690
Infosoft Systems	6,948,520	-
Arben Ismalaj	2,467,520	1,116,720
ABCOM	1,071,591	1,056,835
Sigal Uniqa Group Austria	358,353	1,437,168
Albartex	-	1,005,048
EMKO sh.p.k	-	3,350,160
Other	6,617,889	6,029,080
	30,216,563	26,747,701

13. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera me 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Shpenzime të përlllogaritura	1,948,751	2,040,789
Detyrime të tjera ndaj personelit	88,365,247	66,573,786
Detyrime të tjera	1,268,762	901,816
Tatimi mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore	33,005,783	26,192,065
TVSH e pagueshme	9,155,391	286,243
	133,743,934	95,994,699

14. Detyrimet ndaj palëve të lidhura

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012		
	Në Eur	Në Lek	Në USD	Në Eur	Në Lek
TP Italy(IN&OUT) S.p.a	3,521	493,694	-	664	92,723
Albania Investments Hlg Mauritius	270,041	37,859,695	-	68,106	9,506,980
Teleperformance USA	-	-	2,894	-	306,289
Teleperformance SA	46,539	6,524,832	-	37,900	5,290,447
Teleperformance Deutschland	11,282	1,581,735	-	30,711	4,286,915
	331,383	46,459,956	2,894	137,381	19,483,353

15. Të ardhura

Të ardhurat operative paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
TP Italy (In&OUT) S.p.a	1,548,697,535	1,391,455,340
Gn Research S.p.a	31,113,329	25,380,290
	1,579,810,864	1,416,835,630

Të ardhurat nga shërbimi paraqesin vlerat e faturuara ndaj palëve të lidhura të Shoqërisë, TP Italy (In & Out) S.p.a. dhe GN Research S.p.a.

18. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Udhëtime dhe zbatimje	8,933,551	6,960,635
Shpenzime qiraje	105,822,832	97,562,909
Shërbime ndaj palëve të treta	62,638,079	62,045,724
Shpenzimi konsulence dhe ligjore	5,329,898	5,117,484
Tarifë për të drejta shfrytëzimi	50,367,523	46,035,365
Riparime dhe mirëmbajtje	2,686,322	2,984,763
Ujë dhe drita	15,630,620	14,603,909
Kancelari	5,286,971	5,409,514
Shpenzime reklamimi dhe promocioni	7,299,418	7,866,375
Shpenzime karburanti	3,937,349	2,211,300
Shpenzime sigurimi	1,349,322	1,379,559
Taksa të tjera	1,630,700	1,632,078
Shpenzime të tjera operative	14,156,315	16,101,271
	285,068,900	269,910,886

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

19. Shpenzime dhe të ardhura financiare

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<i>Të ardhura Financiare</i>		
Fitime nga këmbimi	4,872,227	6,514,569
	4,872,227	6,514,569
<i>Shpenzime Financiare</i>		
Shpenzime interesi	(54,052)	(310,766)
Komisione bankare	(700,493)	(730,024)
Humbje nga këmbimi	(9,008,941)	(13,728,289)
	(9,763,486)	(14,769,079)
Shpenzimet financiare neto	(4,891,259)	(8,254,510)

20. Tatimi mbi fitimin

Të njohura në pasqyrën e të ardhurave përmblledhëse:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<i>Tatimi aktual</i>		
Viti aktual	27,167,283	29,097,574
	27,167,283	29,097,574

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 10% të fitimit të tatueshëm (2012: 10%). Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	2013 %	2013 Ne Lek	2012 %	2012 Ne Lek
Fitimi para tatimit		247,455,367		266,182,796
Tatimi fitimi me normë standarde	10%	24,745,537	10%	26,618,280
Shpenzime të pazbritshme	1.0%	2,421,746	0.9%	2,479,294
Tatim fitimi i vitit	11%	27,167,283	10.9%	29,097,574

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 nuk ka patur diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të raportuara për qëllime tatimore. Rrjedhimisht, nuk është njohur aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

21. Palët e lidhura

Shoqëria ka palë të lidhura aksionerët e saj, shoqërinë mëmë përfundimtare, dhe kompanitë që janë nën kontrollin e kompanisë mëmë përfundimtare të grupit.

- In & Out S.p.a (Italy): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- GN Research (Italy): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- O.B Tel S.r.l (Italy): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- Albania Investment Holdings (Mauritius): Aksioner
- Service 800 Albania Sh.p.k (Albania): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- Teleperformance SA (France): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- Teleperformance Deutschland - Service GmbH (Germany): Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare
- Teleperformance USA: Filial i Shoqërisë mëmë përfundimtare

Shoqëria ka gjithashtu palë të lidhura drejtorët dhe oficerët ekzekutivë.

Gjatë vitit Shoqëria ka pasur transaksionet e mëposhtme me palët e lidhura të cilat janë shprehur në monedhen origjinale dhe përkthyer në Lek:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013		
	Ne Lek	Ne Eur	Ne USD
Blerje nga:			
TP Italy (In&OUT) S.p.a	399,922	2,857	-
Albania Investments Jlg Mauritius	37,859,748	270,041	-
Teleperformance SA	6,530,194	46,548	-
Teleperformance Deutschland	3,146,841	22,405	-
Shitje ndaj:			
TP Italy (In&OUT) S.p.a	1,548,697,535	11,039,175	-
Gn Research S.p.a	31,113,329	221,706	-
Service 800 Albania Sh.p.k	10,605,357	75,600	-

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012		
	Ne Lek	Ne Eur	Ne USD
Blerje nga:			
TP Italy (In&OUT) S.p.a	394,217	2,824	-
Albania Investments Jlg Mauritius	38,362,803	274,825	-
Teleperformance USA	306,289	-	2,894
Teleperformance SA	5,290,447	-	-
Teleperformance Deutschland	4,286,915	-	-
Shitje ndaj:			
TP Italy (In&OUT) S.p.a	1,391,455,339	9,983,575	-
Gn Research S.p.a	25,380,290	182,186	-
Service 800 Albania Sh.p.k	8,910,401	63,833	-

Për gjendjet në fund të vitit referoju shënimeve 7 dhe 14.

Kompensimi i drejtuesve kryesorë të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 është 60,928,522 Lek (2012: 49,903,425 Lek).

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

22. Instrumentet financiare- Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut

(a) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to është përafërsisht e njëjtë me vlerën e mbartur të paraqitur, për shkak të maturimit të tyre të shkurtër. Vlera e drejtë e kërkesave të arkëtueshme dhe të pagueshmeve është gjithashtu e përafërt me vlerën e mbartur për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër

(b) Menaxhimi i riskut financiar

Rreziku i kreditimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kërkesa për arkëtim nga palët e treta	305,906,077	252,498,097
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	8,815,217	13,945,813
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	52,852,355	43,918,695
	367,573,649	310,362,605

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë prej kërkesave për arkëtim në datën e raportimit sipas tipit të rajonit gjeografik ishte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vendas	8,664,360	2,638,251
Jo vendas	297,241,717	249,859,846
	305,906,077	252,498,097

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë prej kërkesat për arkëtim në datën e raportimit lidhet plotësisht me shërbime të kryera për palë të lidhura vendase dhe jo vendase.

Humbje nga zhvlerësimi

Analiza sipas vjetërsisë e kërkesave për arkëtim në datën e raportimit është:

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Bruto	Zhvlerësimi	Bruto	Zhvlerësimi
Më pak se një vit	305,906,077	-	252,498,097	-
Gjëndje në fund të vitit	305,906,077	-	252,498,097	-

Risku i likuiditetit

Më poshtë paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit kontraktual duke përfshirë pagesën e interesave më 31 dhjetor 2013 dhe 2012:

31 Dhjetor 2013

	Vlera kontabël	6 ose më pak muaj	6-12 muaj
<i>Aktivet financiare</i>			
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	305,906,077	305,906,077	-
Kërkesa të tjera për arkëtim	8,815,217	8,815,217	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	52,852,355	52,852,355	-
	367,573,649	367,573,649	-
<i>Detyrimet financiare</i>			
Detyrime ndaj palëve të lidhura	46,459,956	46,459,956	-
Llogari të pagueshme	30,216,563	30,216,563	-
Detyrime të tjera	133,743,934	133,743,934	-
	210,420,453	210,420,453	-

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

22. Instrumentet financiare (vazhdim)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2012

	Vlera kontabël	6 ose me pak muaj	6-12 muaj
<i>Aktivitet financiare</i>			
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	252,498,097	252,498,097	-
Kërkesa të tjera për arkëtim	13,945,813	13,945,813	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	43,918,695	43,918,695	-
	310,362,605	310,362,605	-
<i>Detyrimet financiare</i>			
Huatë	666,922	272,764	394,158
Detyrime ndaj palëve të lidhura	19,483,353	19,483,353	-
Llogari të pagueshme	26,747,701	26,747,701	-
Detyrime të tjera	95,994,699	95,994,699	-
	142,892,675	142,498,517	394,158

Risku i monedhës

Ekspozimi ndaj riskut të monedhës

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

31 Dhjetor 2013

	Vlera kontabël	EUR	Lek	USD
<i>(vlerat të paraqitura në Lek)</i>				
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	305,906,077	305,906,077	-	-
Kërkesa të tjera për arkëtim	8,815,217	4,314,797	4,500,420	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	52,852,355	44,151,260	8,701,095	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(46,459,956)	(46,459,956)	-	-
Llogari të pagueshme	(30,216,563)	(3,870,042)	(25,816,286)	(530,235)
Detyrime të tjera	(133,743,934)	(125,868,175)	(7,875,759)	-
Ekspozimi neto	157,153,196	178,173,961	(20,490,530)	(530,235)

Albania Marketing Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

22. Instrumentet financiare (vazhdim)

Risku i monedhës (vazhdim)

31 Dhjetor 2012	Vlera kontabël	EUR	Lek	USD
	<i>(vlerat të paraqitura në Lek)</i>			
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	252,498,097	252,498,097	-	-
Kërkesa të tjera për arkëtim	13,945,813	8,510,230	5,435,582	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	43,918,695	38,785,703	5,132,992	-
Hua	(666,922)	(666,922)	-	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(19,483,353)	(19,177,064)	-	(306,289)
Llogari të pagueshme	(26,747,701)	(7,823,704)	(18,759,760)	(164,237)
Detyrime të tjera	(95,994,699)	(92,445,875)	(3,548,820)	-
Ekspozimi neto	167,469,930	179,680,465	(11,740,006)	(470,525)

Kurset e këmbimit të përdorura gjatë vitit janë si më poshtë

Lek	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit
<i>Euro</i>	140.27	140.20	139.04	139.59
<i>USD</i>	105.69	101.86	108.18	105.85

Analiza e ndjeshmërisë

Një forcim ose dobësim i Lek-ut, sikurse tregohet më poshtë, kundrejt Euro do të zvogëlonte ose rriste respektivisht, kapitalin dhe fitimin apo humbjen me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë bazohet në një ndryshim prej 10% në kursin e këmbimit që Shoqëria e gjykon si të mundshëm në fund të periudhës së raportimit.

Lek	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Kapitali	Fitim / humbje	Kapitali	Fitim / humbje
<i>Euro</i>	16,035,656	16,035,656	16,171,242	16,171,242
<i>USD</i>	(47,721)	(47,721)	(42,347)	(42,347)

Risku i normës së interesit

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Instrumentat me normë të ndryshueshme		
Detyrimet financiare	-	666,922
	-	666,922

Profili

Në datën e raportimit Shoqëria nuk kishte instrumenta me normë fikse.

Analiza e ndjeshmërisë së flukseve të parasë për instrumentet me normë të ndryshueshme

Një ndryshim me 100 pikë në normën e interesit në datën e raportimit do të rriste (zvogëlonte) kapitalin dhe fitimin apo humbjen me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë merr parasysh që të gjithë variablat e tjerë, në mënyrë të veçantë norma e këmbimit, mbeten konstantë:

Çështjet gjyqësore

Shoqëria nuk është subjekt i çështjeve ligjore, pretendimeve dhe mosmarrëveshjeve të lindura në kushte të zakonshme biznesi. Drejtuesit e Shoqërisë mendojnë që pretendimet e mundëshme të ardhshme nuk do të kenë një efekt material të padëshiruar në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatin e aktiviteteve operative apo flukseve të parasë.

Angazhime për qira operative

Pagesat minimale, të ardhshme të qirasë të lidhura me qiranë operative janë si vijon:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Brenda një viti	51,658,258	36,347,787
Mbi një por jo më shumë se pesë vjet	-	12,847,296
Më shumë se 5 vite	-	-
	<u>51,658,258</u>	<u>49,195,083</u>

24. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtuesit e Shoqërisë nuk janë në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së raportimit e cila mund të kërkojë rregullim ose nota shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.